

Pas mbylljes së sporteve fizike prej dates 1 Maj 2022, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në zbatim të akteve ligjore në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike vetëm online dhe Urdhërit të Kryeministrit nr. 87 datë 13.05.2022 “Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve” po bashkëpunon me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) lidhur me:

- Monitorimin e zbatimit të afateve të përdorimit të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve, deri në marrjen e shërbimit e të dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik nga qytetarët dhe subjektet sipas afateve ligjore, si dhe;
- Ndjekjen e ecurisë së ankesave të administruara nga ADB-ja për mënyrën e ofrimit të shërbimeve nga institucionet shtetërore në nivel qarku.

Në këtë kuadër, është nënshkruar dhe Urdhri i përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së”, lidhur me organizimin e punës dhe hapat që do të ndiqen në bashkëpunimin ndërmjet dy agjencive.

Gjithashtu, është miratuar Vendimi nr. 26, datë 27.1.2023 i Këshillit të Ministrave “Për bazën e të dhënave të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, rregullat e detajuara për seksionet e saj, të dhënat parësore e dytësore, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, sistemet elektronike dhe protokollat e institucioneve”; si dhe Vendimi nr. 43, datë 01.02.2023 i Këshillit të Ministrave “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të nevojës, hartimit, bashkëpunimit, miratimit dhe funksionimit të metodave apo të seksioneve të reja të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.

ADISA ka vënë në dispozicion të qytetarëve dhe ofron suport të plotë nëpërmjet **numrit jeshil 0800 0118 të Qendrës së Informimit për Shërbimet Publike (call center) ADISA, chat-it në adresën www.adisa.gov.al dhe email informacion@adisa.gov.al**, e cila tashmë është kthyer në qendrën kombëtare të informimit për rreth 1200 shërbime publike nga 65 institucione, dhe ofron asistencë të plotë për të gjitha kategoritë dhe grupmoshat e qytetarëve lidhur me këto shërbime publike (mbi përdorimin e portalit, për procedurën e aplikimit, për hapjen e llogarisë në portalin e-albania, informacion për të gjitha shërbimet publike, dhe çdo asistencë tjetër që lidhet me to etj).